

“S-SARANDA” Sh.P.K.

K54208810J

Çukë, Sarandë, Shqipëri.

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 43.303.316,84.

PROCESVERBAL

I

ASAMBLESE SË PËRGJITSHME TË ORTAKËVE

Sot, më 15.06.2017, në orën 10:00 (ora standarde në Tiranë), në adresën: Rr. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, 5/4, Tiranë, Shqipëri, sipas njoftimit fillestar të dhënë më datë 20.04.2017, të përsëritur më datë 24.05.2017 (për efekt shtyrje si rrjedhojë e kërkesës së ortakut tjetër Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes), nga **Z. Thoma JANI**, ortak i shoqërisë “S-SARANDA” Sh.P.K, një shoqëri e regjistruar dhe që operon sipas legjislacionit në Republikën e Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numri unik të identifikimit të biznesit K54208810J, me kapital të regjistruar në vlerën 43.303.316,84.00 Lekë (më poshtë referuar si “Shoqëria”) dhe e zotëruar nga ortakët në vijim:

- a. **Z. Thoma JANI**, shtetas shqiptar, lindur më 16.01.1953, në Cërrik, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Greqi, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 030944587, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zotëron një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 51.00 % (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- b. **Z. Vasilios IATROU**, shtetas amerikan, lindur më 15.01.1947, në Sarandë, Shqipëri dhe banues në New York, SHBA, mbajtës i pasaportës Nr. 112744727, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zotëron një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 19.00 % (nëntëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;

dhe

- c. **Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, e cila zotëron një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 30.00 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë. Në këtë mbledhje Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është përfaqësuar përmes Autorizimit Nr. 5149/1 Prot., datë 05.06.2017, nga **Z. Stefanaq KOÇOLLARI**, shtetas shqiptar, lindur më 28.11.1957, në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 024395840 dhe me numër personal F71128119M, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për të vendosur mbi çështjet në vijim të rendit të ditës

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i ndryshimeve të nevojshme të Statutit në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;
2. Miratimi i ndryshimit të administratorit të Shoqërisë, duke shkarkuar nga detyra administratorin aktual **Z. Vasilios Iatrou** dhe paraqitjen për miratim të administratorit të ri të Shoqërisë, **Z. Thoma JANI**, shtetas shqiptar, lindur më 16.01.1953, në Cërrik, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Greqi, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 030944587, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

1

“S-SARANDA” Sh.P.K.

K54208810J

Çukë, Sarandë, Shqipëri.

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 43.303.316,84.

3. Shitja e kuotës së zotëruar nga Z. Thoma Jani në kapitalin e Shoqërisë e barabartë me 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të Shoqërisë dhe prezantimi i blerësve të synuar, Z. Glon Bakalli, lindur më 10.08.1977, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 027651778, të cilit i shitet 26% (njëzet e gjashtë për qind) e kuotës së zotëruar nga Z. Thoma Jani në kapitalin e Shoqërisë; dhe Z. Aldens Allmuça, lindur më 15.05.1983, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 028718164, të cilit i shitet 25% (njëzet e pesë për qind) e kuotës së zotëruar nga Z. Thoma Jani, në kapitalin e Shoqërisë. Çmimi total i shitjes së 51% (pesëdhjetë e një për qind) e kuotës së zotëruar nga Z. Thoma Jani në kapitalin e Shoqërisë është 67,000.00 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë) Euro;
4. Paraqitja për miratim e Marrëveshjes Për Shitje Kuote Me Kusht, datë 07.02.2017, nënshkruar nga Z. Glon Bakalli dhe Z. Aldens Allmuça në cilësinë e blerësve dhe Z. Thoma Jani në cilësinë e Shitësit; dhe
5. Çështje të tjera.


Ortakët e pranishëm në mbledhje caktojnë **Z. Thoma Jani** si kryesues të mbledhjes dhe ai cakton si sekretare të mbledhjes **Zj. Lorena Uliu** për mbajtjen e procesverbalit të kësaj mbledhjeje.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të hapur, pasi konstatoi se njoftimi mbi këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve është bërë rregullisht për të gjithë ortakët dhe se në mbledhje janë të pranishëm personalisht, ose me prokurë/autorizim ortakët që zotërojnë 81% (tetëdhjetë e një për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë e që përbën kuorumin e nevojshëm për këtë mbledhje, ndërsa Z. Vasilios Iatrou, administrator dhe zotërues i 19% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, pavarësisht se është njoftuar rregullisht në adresën e tij zyrtare të regjistruar në Statut dhe në librat e tjerë të Shoqërisë përmes njoftimit të datës 20.04.2017, përsëritur më datë 24.05.2017, nuk është i pranishëm në mbledhje dhe as ka njoftuar, ose shprehur në ndonjë mënyrë qëndrimin e tij për këtë mbledhje. Kjo mbledhje i është kërkuar fillimisht administratorit për ta thirrur, përmes kërkesës për thirrjen e asamblesë së ortakëve datë 07.02.2017, mirëpo në mungesë të ndonjë përgjigjeje nga administratori i Shoqërisë, ortaku kërkues Z. Thoma Jani u detyrua të procedonte me lëshimin e njoftimit, sikurse referohet më sipër. Mbledhja ishte parashikuar të mbahej më datë 10.05.2017, ora 10:00 në të njëjtën adresë, mirëpo si rrjedhojë e kërkesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Nr. 4539/1 Prot., datë 08.05.2017 për shtyrjen e saj, u vendos të shtyhej data e mbajtjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme për në ditën dhe orarin në të cilin ajo mbahet sot, shtyrje e cila i është njoftuar rregullisht ortakëve të Shoqërisë.

- Pika e parë e rendit të ditës – Miratimi i ndryshimeve të nevojshme të Statutit në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Vendimi. Duke marrë parasysh se Statuti aktual i Shoqërisë është hartuar në vitin 1993 në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe në vitin 2008 është miratuar një ligj i ri i cili ka shfuqizuar dhe ndryshuar kuadrin rregullator në fushën tregtare, përkatësisht Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, statuti aktual i Shoqërisë bie në kundërshtim në disa pika me Ligjin e ri, prandaj është e detyrueshme që Statuti të azhurnohet në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Më tej, në lidhje me këtë pikë, është reflektuar dhe qëndrimi i ortakut të Shoqërisë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Nr. 5149/2 Prot, datë



2


“S-SARANDA” Sh.P.K.

K54208810J

Çukë, Sarandë, Shqipëri.

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 43.303.316,84.

05.06.2017 në lidhje me strukturën e menaxhimit të Shoqërisë, duke përdorur një strukturë të thjeshtë me një administrator. Në këto kushte, ortakët e pranishëm të Shoqërisë bien dakord dhe miratojnë përmbajtjen e Statutit të azhurnuar, sipas formatit bashkëlidhur, i cili miratohet dhe firmoset rregullisht prej tyre.

- **Pika e dytë e rendit të ditës** – Miratimi i ndryshimit të administratorit të Shoqërisë, duke shkarkuar nga detyra administratorin aktual Z. Vasilios Iatrou dhe paraqitjen për miratim të administratorit të ri të Shoqërisë, **Z. Thoma JANI**, shtetas shqiptar, lindur më 16.01.1953, në Cërrik, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Greqi, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 030944587, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Vendimi. Duke marrë parasysh se Z. Vasilios Iatrou ka qëndruar në detyrë për një periudhë shumë vjeçare duke tejkuluar afatin ligjor të parashikuar nga ligji për administratorët dhe për më tepër gjatë kësaj kohe nuk ka ushtruar në mënyrë të saktë funksionet e tij sipas Statutit dhe ligjit në fuqi, ortakët e pranishëm kanë vendosur të shkarkojnë atë nga funksioni, funksion i cili ka përfunduar *ex lege* dhe të miratojnë si administrator të Shoqërisë **Z. Thoma JANI**, shtetas shqiptar, lindur më 16.01.1953, në Cërrik, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Greqi, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 030944587, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili do ta drejtojë Shoqërinë për një afat tre vjeçar, me të drejtë riemërimi.

- **Pika e tretë e rendit të ditës** – Shitja e kuotës së zotëruar nga Z. Thoma Jani në kapitalin e Shoqërisë e barabartë me 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të Shoqërisë dhe prezantimi i blerësve të synuar, Z. Glon Bakalli, lindur më 10.08.1977, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 027651778, të cilit i shitet 26% (njëzet e gjashtë për qind) e kuotës së zotëruar nga Z. Thoma Jani në kapitalin e Shoqërisë; dhe Z. Aldens Allmuça, lindur më 15.05.1983, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 028718164, të cilit i shitet 25% (njëzet e pesë për qind) e kuotës së zotëruar nga Z. Thoma Jani, në kapitalin e Shoqërisë. Çmimi total i shitjes së 51% (pesëdhjetë e një për qind) e kuotës së zotëruar nga Z. Thoma Jani në kapitalin e Shoqërisë është 67,000.00 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë) Euro;

Vendimi. Bazuar në Nenin 9 të Statutit aktual të Shoqërisë dhe legjislacionit shqiptar në fuqi, janë respektuar kërkesat për parablerjen e pjesës së kuotës së kërkuar për shitje, përmes dërgimit të njoftimeve përkatëse më datë 07.02.2017 në adresat zyrtare të të dy ortakëve të tjerë dhe se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përmes shkresës Nr. 1075/1 Prot., datë 02.03.2017 ka refuzuar blerjen e kuotave të ofruara, ndërsa ortaku tjetër Z. Vasilios IATROU nuk ka kthyer asnjë përgjigje brenda afatit kohor të përcaktuar në kërkesë. Megjithatë, ortakët pas diskutimeve ndërmjet tyre, sipas propozimit të ortakut shitës Z. Thoma Jani, vendosën që specifikisht këtë pikë të rendit të ditës, t`a adresojnë për miratim në Asamblenë e Ardhshme të ortakëve që do të mbahet për këtë qëllim.

- **Pika e katërt e rendit të ditës** – Paraqitja për miratim e Marrëveshjes Për Shitje Kuote me Kusht, datë 07.02.2017, nënshkruar nga Z. Glon Bakalli dhe Z. Aldens Allmuça në cilësinë e blerësve dhe Z. Thoma JANI në cilësinë e Shitësit.

3

“S-SARANDA” Sh.P.K.

K54208810J

Çukë, Sarandë, Shqipëri.

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 43.303.316,84.

Vendimi. Në vijim e në përputhje me atë çfarë u vendos në pikën tre të rendit të ditës më sipër, sipas propozimit të ortakut shitës Z. Thoma Jani, ortakët vendosën që specifikisht këtë pikë të rendit të ditës, ta adresojnë për miratim ne asamblenë e ardhshme të ortakëve që do të mbahet për këtë qëllim.

Meqenëse pikat e Rendit të Ditës u diskutuan nga ortakët e pranishëm në mbledhje dhe nuk ka çështje të tjera për të diskutuar, Asambleja e Përgjithshme deklarohet e mbyllur në orën 12:30 (ora standarde lokale).

KRYETARI
Z. Thoma JANI

SEKRETARJA
Zj. Lorena Uliu

Thoma Jani
[Signature]



Lorena Uliu
[Signature]

“S-SARANDA” Sh.P.K.

K54208810J

Çukë, Sarandë, Shqipëri.

Subscribed & Paid-In Capital: ALL 43.303.316,84.

LISTA E ORTAKËVE PJESËMARRËS

Në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të mbajtur sot, më datë 15.06.2017, që filloi në orën 10:00 (ora standarde lokale) dhe përfundoi në orën 12:30 (ora standarde lokale), në adresën: Rr. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, 5/4, Tiranë, Shqipëri, ishin të pranishëm dhe morën pjesë ortakët në vijim:

1. **Z. Thoma JANI**, shtetas shqiptar, lindur më 16.01.1953, në Cërrik, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Greqi, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 030944587, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zotëron një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 51.00 % (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;

dhe


2. **Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, e cila zotëron një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 30.00 % (tridhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, e përfaqësuar për efekt të kësaj mbledhjeje përmes Autorizimit Nr. 5149/1 Prot., datë 05.06.2017, nga **Z. Stefanaq KOÇOLLARI**, shtetas shqiptar, lindur më 28.11.1957, në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 024395840 dhe me numër personal F71128119M, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Pavarësisht njoftimit të rregullt në adresën zyrtare të tij, ortaku tjetër i Shoqërisë **Z. Vasilios Iatrou** nuk ishte i pranishëm në mbledhje dhe nuk depozitoi ndonjë akt lidhur me mos praninë e tij.


PJESËMARRËSIT:

Z. Thoma JANI

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
(Përfaqësuar rregullisht nga Z. Stefanaq Koçollari)

Thoma Jani




Stefanaq Koçollari


STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“S-SARANDA” SH.P.K.

Qershor 2017

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I NENE TË PËRGJITHSHME	1
Neni 1 Emri	1
Neni 2 Legjislacioni i zbatueshëm.....	1
Neni 3 Selia e Shoqërisë.....	1
Neni 4 Forma Ligjore.....	2
Neni 5 Kohëzgjatja.....	2
Neni 6 Përgjegjësia	2
Neni 7 Objekti i Shoqërisë.....	2
Neni 8 Veprimtaria e Shoqërisë.....	3
PJESA II KAPITALI I SHOQËRISË DHE PJESËMARRJA	3
Neni 9 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë.....	3
Neni 10 Administrimi i Kapitalit të Regjistruar	4
PJESA III TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE	5
Neni 11 Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve.....	5
Neni 12 Transferimi i Kuotave.....	5
PJESA IV ASAMBLEJA E ORTAKËVE	6
Neni 13 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve.....	6
Neni 14 Thirrja e Asamblesë së Ortakëve.....	8
Neni 15 Pjesëmarrja në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve.....	9
Neni 16 Drejtimi i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve	9
Neni 17 Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.....	10
Neni 18 Paditë kundër vendimeve të Asamblesë së Ortakëve	10
PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË	11
Neni 19 Administratori.....	11
Neni 20 Kontabiliteti, Viti Financiar dhe Dokumentet financiare.....	12
Neni 21 Fitimi i Shoqërisë dhe fondet rezervë	13
Neni 22 Kontrolli financiar.....	14
Neni 23 Punësimi	14
PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI	14
Neni 24 Prishja dhe likuidimi	14
Neni 25 Likuidimi.....	15
PJESA VIII TË PËRGJITHSHME	15
Neni 26 Të ndryshme.....	15
Neni 27 Ekzemplare.....	16

PJESA I
NENE TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Emri

- 1.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar emërtohet “S-Saranda” Sh.P.K. (në vijim referuar shkurt si “**Shoqëria**”), e cila do të jetë një person juridik shqiptar.
- 1.2 Shoqëria do të gëzojë të gjitha të drejtat si person juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi, këtij Statuti dhe “Kontratës për Krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K.)”, nënshkruar më datë 07.07.1993 ndërmjet palëve themeluese, Z. Vasil Jatru dhe ndërmarrjes së Konservimit të Peshkut dhe Midhjes, Sarandë (në vijim referuar shkurt si “**Akti i Themelimit**”).

Neni 2

Legjislacioni i zbatueshëm

- 2.1 Shoqëria është krijuar dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar të zbatueshëm në fuqi dhe mbi bazën e Aktit të Themelimit të lidhur ndërmjet palëve themeluese, këtij Statuti, si dhe të dokumenteve të tjera të miratuara nga organet e Shoqërisë.
- 2.2 Shoqëria do të kryejë në emër të saj të gjitha veprimet dhe mosveprimet të cilat sipas legjislacionit shqiptar në fuqi janë të lejueshme për t'u realizuar në përputhje me objektin e saj tregtar, *inter alia*, të lidhë kontrata, të fitojë të drejta pasurore dhe të drejta të tjera personale jo pasurore, të marrë përsipër detyrime, të veprojë si paditës, ose i paditur në Gjykatë, në procedura Arbitrazhi ose përpara një Gjykate Arbitrazhi, etj.

Neni 3

Selia e Shoqërisë

- 3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Çukë, Sarandë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi në adresa të tjera, brenda, ose jashtë vendit. Degët, filiale dhe/ose zyrat e përfaqësimit të hapura do të veprojnë në përputhje me rregulloret e veçanta të miratuara për to sipas këtij Statuti dhe me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ose në vende të tjera ku ata hapen, sipas rastit dhe për sa është e zbatueshme.



Neni 4

Forma Ligjore

- 4.1 Shoqëria është një person juridik shqiptar, i themeluar si një sipërmarrje e përbashkët në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.
- 4.2 Shoqëria ka vulën e saj, modeli i së cilës miratohet nga Administratori. Dokumentet zyrtare të Shoqërisë do të mbajnë vulën e saj, e cila mirëmbahet dhe është përgjegjësi e Administratorit të Shoqërisë.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë (aktivitetit) të Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit.

Neni 6

Përgjegjësia

- 6.1 Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet e saj. Ortakët janë përgjegjës deri në vlerën e pjesës së pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

Neni 7

Objekti i Shoqërisë

- 7.1 Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në:
1. Përpunimin dhe konservimin e peshkut dhe midhjes;
 2. Magazinimin dhe shpërndarjen e prodhimeve të detit të përpunuara, ose të freskëta;
 3. Eksportimin, importimin, blerjen, shitjen, ruajtjen, tregtimin dhe transportimin e lëndëve të para, makinerive, pjesëve të këmbimit, produkteve të gatshme, lëndëve ndihmëse që kanë lidhje me objektin tregtar të Shoqërisë;
 4. Kryerjen e investimeve në lidhje me objektin e Shoqërisë.
 5. Çdo operacion financiar, bankar që ka lidhje, ose jo me sa më sipër dhe që gjykohet i favorshëm për Shoqërinë.
- 7.2 Shoqëria mund të ushtrojë dhe çdo veprimtari tjetër të ligjshme e cila është në përputhje me dhe i shërben përbushjes e arritjes së objektit të saj të referuar më lart.



Neni 8

Veprimtaria e Shoqërisë

- 8.1 Veprimtaria e Shoqërisë do të bazohet në parimin e maksimizimit të fitimit dhe krijimit të të ardhurave ekonomike për ortakët, të cilat financiarisht reflektohen edhe në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
- 8.2 Shoqëria do të sigurojë të ardhurat e saj përmes shitjes së produkteve të saj në tregun vendas, ose të huaj, të ardhura të cilat do të përdoren për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë dhe për shpërndarjen e fitimeve eventuale ortakëve të saj, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe parashikimeve të këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit.
- 8.3 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar mbi bazën e planeve të hartuara nga organet kompetente dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me rregullat zyrtare të kontabilitetit, duke u financuar dhe mbështetur kryesisht në fondet e veta.
- 8.4 Shoqëria do të administrojë vetë pasuritë e veta dhe do të ketë të drejtën e përdorimit dhe posedimit të këtyre pasurive në përputhje me qëllimet dhe objektivat e veprimtarisë së saj dhe me legjislacionin në fuqi e me parashikimet e këtij Statuti dhe akteve të tjera të brendshme. Shoqëria gjithashtu gëzon të drejtën e mbrojtjes së pronës dhe interesave ligjore të saj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 8.5 Shoqëria do të administrohet në përputhje me Aktin e Themelimit, këtë Statut dhe me legjislacionin në fuqi.

PJESA II

KAPITALI I SHOQËRISË DHE PJESËMARRJA

Neni 9

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë

- 9.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është në vlerën 43.303.316,84 Lekë. Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga tre ortakë sipas strukturës më poshtë:
 - **Z. Thoma JANI**, shtetas shqiptar, lindur më 16.01.1953, në Cërrik, Elbasan, Shqipëri dhe banues në Greqi, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 030944587, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zotëron një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 220,846.91 Lekë, që përfaqëson 51.00 % (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
 - **Z. Vasilios IATROU**, shtetas amerikan, lindur më 15.01.1947, në Sarandë, Shqipëri dhe banues në New York, SHBA, mbajtës i pasaportës Nr. 112744727, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, i cili zotëron një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 82,276.30 Lekë, që përfaqëson 19.00 % (nëntëmbëdhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë; dhe



- **Shteti Shqiptar**, i përfaqësuar nga **Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, e cila zotëron një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 129,909.948 Lekë, që përfaqëson 30% të kapitalit të Shoqërisë.
- 9.2 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të rritet në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi edhe përmes kontributeve në natyrë.
- Në rast rritje të kapitalit, pjesët e reja do t'i ofrohen fillimisht ortakëve ekzistues, në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë. Ftesa përkatëse për rritjen e kapitalit të regjistruar dhe si rrjedhojë për rritjen e kontributit në kapitalin e regjistruar Shoqërisë do t'i dërgohet ortakëve nga Administratori së bashku me arsyetimin përkatës. Ortakët kanë të drejtë të pranojnë, ose refuzojnë rritjen e kontributit brenda 7 (shtatë) ditësh nga marrja e njoftimit, në të kundërt, moskthimi i një përgjigjeje do të konsiderohet si refuzim. Pjesën e refuzuar nga ndonjëri prej ortakëve, Administratori do t'ua ofrojë ortakëve të tjerë brenda 3 (tre) ditësh nga refuzimi i ortakut, në përputhje me pjesëmarrjen e tyre eventuale pas rritjes. Ortakët e tjerë do të kenë të drejtën të përgjigjen për blerjen e pjesës së refuzuar nga ortakut brenda 5 (pesë) ditësh nga marrja e njoftimit. Në rast se asnjë nga ortakët nuk dëshiron të blejë pjesën e rritjes së kapitalit të refuzuar, ose në rast se ato kanë pranuar vetëm pjesë të saj, atëherë Shoqëria do t'ia ofrojë atë, ose pjesë të saj sipas rastit, palëve të tretë.
- 9.3 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zvogëlohet në rast se ai tejkalon kufijtë e kapitalit të nevojshëm për realizimin e qëllimit të Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe të legjislacionit në fuqi. Parashikimet e Pikës 9.2 më lart do të zbatohen në këtë rast për sa janë të aplikueshme *mutatis mutandis*.
- 9.4 Në rast ulje të kapitalit të Shoqërisë nën kapitalin e regjistruar të saj, kapitali do të plotësohet përmes të ardhurave nga aktiviteti ekonomik i Shoqërisë dhe nga kontributet shtesë të ortakëve të saj në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 9.5 Pjesëmarrja në kapitalin e Shoqërisë mund të ndryshojë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 10

Administrimi i Kapitalit të Regjistruar

- 10.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë dhe të dhënat përkatëse për të do të detajohen në librat e Shoqërisë dhe në aktet e tjera zyrtare të zbatueshme.
- 10.2 Shoqëria ka të drejtën e kontrollit të plotë mbi Kapitalin e saj të Regjistruar të kontribuar nga Ortakët.



- 10.3 Ortakët nuk kanë të drejta të veçanta mbi objekte individuale që formojnë pjesë të pronës së Shoqërisë edhe sikur të jenë blerë nga një Ortak si kontribut, përveç sa parashikuar ndryshe në këtë Statut.

PJESA III TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e ortakëve

- 11.1 Çdo ortak ka të drejtat e mëposhtme:

- (a) të votojë në Asamblenë e Ortakëve. E drejta e votës ushtrohet dhe llogaritet në proporcion me vlerën përkatëse të kontributeve dhe përqindjes së zotëruar në kapitalin e Shoqërisë nga secili ortak.
- (b) të përfitojë dividendë në rast shpërndarje të fitimit, si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë, në proporcion me përqindjen e zotëruar në kapitalin e Shoqërisë, ose sikurse mund të përcaktohet ndryshe me vendim të Asamblesë së Ortakëve në bazë të Statutit, Aktit të Themelimit dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.
- (c) t'i vihet në dispozicion regjistrimet, të dhënat, si dhe të gjitha dokumentet dhe faktet e tjera që lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë, llogaritë e saj, etj.
- (d) të largohet nga Shoqëria sipas parashikimeve të Statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- (e) të sigurojë ekspertizën dhe të dhënat e nevojshme për zhvillimin e planeve ekonomiko – financiare dhe për mbarëvajtjen e operacioneve të Shoqërisë.
- (f) të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve qoftë personalisht, ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar në përputhje me parashikimet e ligjit.
- (g) të drejta të tjera të njohura nga Marrëveshja, Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

- 11.2 Ortakët kanë detyrimin të nënshkruajnë dhe paguajnë kuotën përkatëse, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë kur ftohen rregullisht, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj, si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur, brenda qëllimit dhe kompetencave përkatëse të tyre.

Neni 12

Transferimi i Kuotave

- 12.1 Kuotat, ose çdo pjesë e tyre, të drejtat, interesat ose detyrimet që lidhen me to, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 12.2 Një Ortak do të transferojë kuotën përkatëse ose çdo pjesë të saj, të drejtat, interesat ose detyrimin e tij në, ose si rrjedhojë e angazhimit në Shoqëri drejtpërdrejt ose jo vetëm në përputhje me këtë Statut. Çdo përpjekje për të transferuar kuotën përkatëse, ose pjesë të saj, në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të Ortakut(ëve) të tjerë, do të jetë nul dhe i pavlefshëm *ex tunc*.
- 12.3 Një Ortak që propozon të transferojë, ose shesë kuotën përkatëse ose pjesë të saj nga sa zotëron në Shoqëri ("Transferuesi") tek një palë e tretë përfituese ("Përfituesi i Propozuar"), duhet t'ia ofrojë këtë kuotë ("Kuota që Shitet") paraprakisht Ortakut(ëve) të tjerë ("Ortaku(ët) i/e Mbetur") në proporcion të njëjtë me pjesëmarrjen e Ortakut/ëve të Mbetur në kapitalin e Shoqërisë në atë moment, duke i dërguar një njoftim me shkrim ("Njoftimi i Transfertës") tek Ortaku(ët) i/e Mbetur. Njoftimi i Transfertës i dërgohet Shoqërisë dhe Ortakëve në adresat zyrtare dhe specifikon kuotën në tërësi, ose pjesë të saj të propozuara për t'u transferuar ("Kuota për Shitje"), përqindjen e pjesëmarrjes/zotërimit të Kuotës për Shitje që Ortaku(ët) i/e Mbetur ka/në të drejtë të blejnë, identitetin e Përfituesit të Propozuar, çmimin e Kuotës për Shitje të ofruar nga Përfituesi i Propozuar dhe çdo material tjetër dhe kushte dhe afate të tjera për shitjen e propozuar. Në çdo rast, Transferuesi do t'i japë Ortakut/ëve të Mbetur 7 (shtatë) ditë kohë për t'u përgjigjur.
- 12.4 Ortaku(ët) e Mbetur kanë të drejtën, por jo detyrimin për të blerë Kuotën për Shitje ("E Drejta e Parablerjes"), duke njoftuar Transferuesin për pranimin, ose jo të ofertës për të blerë Kuotën për Shitje (ose çdo pjesë të saj që i përket atij Ortaku(ëve) të Mbetur), në çmimin sikurse përmendet në Njoftimin e Transfertës ("Njoftimi i Pranimit të të Drejtës së Parablerjes"). Transferimi i Kuotës për Shitje nga Transferuesi tek Ortaku(ët) i/e Mbetur do të përfundohet brenda një periudhe prej 8 (tetë) ditësh nga data e marrjes së Njoftimit të Pranimit të të Drejtës së Parablerjes. Nëse Ortaku(ët) i/e Mbetur refuzon/jnë, ose nuk pranon/jnë ofertën e Transferuesit brenda tre muajve nga data e marrjes dijeni për Njoftimin e Transfertës, Transferuesi do të ketë të drejtën të shesë, ose transferojë Kuotën për Shitje (ose pjesë të saj për të cilin nuk është marrë një Njoftim Pranimi i të Drejtës së Parablerjes) tek Transferuesi i Propozuar në çmimin dhe sipas kushteve të ofruara në Njoftimin e Transfertës.

PJESA IV
ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Neni 13
Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve



- 13.1 Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë, i cili ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me çështje të veprimtarisë së saj. Vendimet e saj, Asambleja e Ortakëve do t'i marrë në mbledhjet e ortakëve të saj, të cilat do të mbahen në përputhje me këtë Statut dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 13.2 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve mbahet të paktën një herë në vit, brenda tre muajve nga përfundimi i vitit financiar të Shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve merr vendime me shumicë të zakonshme, ose me shumicë të jashtëzakonshme. Nëse Asambleja e Ortakëve thirret në mënyrë të rregullt por nuk është i pranishëm ose i përfaqësuar numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë Asambleja do të thirret përsëri brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite dhe të gjithë ortakët do të njoftohen rregullisht në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.
- 13.3 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve merr vendime me shumicë të zakonshme mbi:
- (a) politikat e biznesit;
 - (b) miratimin dhe ndryshimin e raporteve të ecurisë së biznesit, planin e biznesit, planin e buxhetit dhe planin për nxitjen e administrimit;
 - (c) miratimin e pasqyrave financiare vjetor dhe shpërndarjen e fitimeve;
 - (d) drejtësinë strategjike, zonën gjeografike ose linjat e biznesit të Shoqërisë;
 - (e) dhënien me qira të ndërmarrjes, shitjen, ose blerjen e aseteve (me anë të blerjes së pjesëmarrjes, aseteve, apo tujave të tjerë në një shoqëri tjetër, me bashkim ose ndryshe) vlera kontabël e të cilave tejkalon 20% (njëzetë për qind) të totalit të aseteve të Shoqërisë sipas bilancit të fundit të certifikuar;
 - (f) marrjen përsipër të çdo detyrimi, ose vendosjen garanci të aseteve të Shoqërisë të cilat tejkalojnë vlerën kontabël prej 20% (njëzetë për qind) të totalit të aseteve të Shoqërisë sipas bilancit të fundit të certifikuar;
 - (g) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
 - (h) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit/ëve kontabël të autorizuar dhe caktimin e shpërblimit përkatës;
 - (i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procese të tjera kundër dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit; dhe
 - (j) çdo çështje tjetër të përcaktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- 13.4 Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime me shumicë të zakonshme nëse janë të pranishëm, a të përfaqësuar ortakët që përfaqësojnë dhe zotërojnë më tepër se gjysmën e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve merr vendime me votën pro të ortakëve të cilët përfaqësojnë më tepër se gjysmën e kapitalit të përfaqësuar në atë mbledhje të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- 13.5 Asambleja merr vendime me shumicë të jashtëzakonshme mbi:
- (a) ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
 - (b) rritjen, ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;



- (c) ndarjen e kuotave;
 - (d) shpërndarjen e fitimeve
 - (e) dhënieën me qira, shitjen, ose blerjen e aseteve (me anë të blerjes së pjesëmarrjes, aseteve, apo titujve të tjerë në një shoqëri tjetër, me bashkim ose ndryshe) vlera kontabël e të cilave tejkalon 50% (pesëdhjetë për qind) të totalit të aseteve të Shoqërisë sipas pasqyrave të fundit financiare të certifikuara;
 - (f) marrjen përsipër të çdo detyrimi ose vendosjen garanci të aseteve të Shoqërisë të cilat tejkalojnë vlerën kontabël prej 50% (pesëdhjetë për qind) të totalit të aseteve të Shoqërisë sipas pasqyrave të fundit financiare të certifikuara;
 - (g) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe përcaktimin e shpërblimit përkatës;
 - (h) ristrukturimin, shpërndarjen, transformimin, ose ri-organizimin e Shoqërisë në ndonjë formë tjetër, bashkimin, thithjen, përthithjen, ndarjen, ose likuidimin e Shoqërisë; dhe
 - (i) ndërmarrjen e çdo veprimi që në mënyrë të pritshme do të shkaktonte një rast likuidimi.
- 13.6 Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime me shumicë të cilësuar nëse janë të pranishëm, a të përfaqësuar ortakët që përfaqësojnë dhe zotërojnë më tepër se 3/4 (tre të katërtat) e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve merr vendime me votën pro të ortakëve të cilët përfaqësojnë më tepër se gjysmën e kapitalit të përfaqësuar në atë mbledhje të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- 13.7 Votimi në mbledhjet Asamblesë së Ortakëve do të mbahet i hapur dhe vetëm në raste përjashtimore, për çështje të një rëndësie të veçantë, vendimi mund të merret me votim të fshehtë, në përputhje me parashikimet statutore, kur këtë e kërkojnë ortakët që përfaqësojnë të paktën 10% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Neni 14

Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 14.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori të paktën një herë në vit, në selinë e Shoqërisë, ose në ndonjë vend tjetër. Gjithashtu, Administratori ka detyrimin të thërrasë Asamblesë të Ortakëve, ose të përfshijë një çështje në rendin e ditës, nëse diçka e tillë kërkohet me shkrim nga të paktën një, ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë). Nëse Asambleja e Ortakëve nuk thërritet nga Administratori brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e kërkesës së ortakëve, ose nëse çështja e kërkuar nuk përfshihet në rendin e ditës, ortaku, ose ortakët që zotërojnë të paktën 5 % (pesë për qind) të kapitalit të regjistruar me të drejtë vote të Shoqërisë, mund të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve në përputhje me këtë Statut.
- 14.2 Asambleja e Ortakëve do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga Administratori nëpërmjet një letre rekomande, apo adrese elektronike (E-mail), ose telex-i, apo faksi në adresat e ortakëve të regjistruara në librin e ortakëve. Njoftimi duhet të dërgohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes dhe do të

përmbajë rendin e ditës, vendin e mbajtjes së mbledhjes, datën dhe orën e saj dhe do të përfshijë gjithashtu dhe pasqyrat financiare, raportin e ecurisë së biznesit, planin biznesor, ose dokumente të tjera sipas rastit. Ftesa e shkruar do të regjistrohet në librin e procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve. Njoftimi duhet të përcaktojë dhe datën e ardhshme të mbajtjes së mbledhjes, në rast se ajo do të shtyhet me të njëjtin rend dite për shkaqe të mos plotësimi të kuorumit në mbledhjen e parë.

- 14.3 Asambleja e Ortakëve që nuk është mbajtur në përputhje me parashikimet e mësipërme, do të konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe do mund të marrë vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët të cilët përfaqësojnë të gjitha kapitalin e Shoqërisë dhe bien dakord për një gjë të tillë.
- 14.4 Ortakët e pranishëm në mbledhje, konsiderohet se kanë marrë dijeni për datën e mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve. Nëse data për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë Ortakët kanë qenë prezentë, atëherë Ortakët do të vlerësohen si të njoftuar.

Neni 15

Pjesëmarrja në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve

- 15.1 Çdo Ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, të cilët do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.2 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, telekonferencës, video konferencës apo mjeteve të tjera të komunikimit, me kusht që të sigurohet identifikimi i pjesëmarrësve dhe i pranisë së tyre dhe mjeteve elektronike të përdorur të garantojnë transmetimin *live*, në kohë reale të komunikimit të ndërsjellë, duke i dhënë mundësinë Ortakëve të adresojnë dhe diskutojnë nga vende të tjera dhe të jenë objekt i masave të tilla teknike që sigurojnë sigurinë e komunikimit elektronik deri në masën e përdorimit proporcional në arritjen e qëllimeve. Me plotësimin dhe zbatimin e këtyre kritereve, Asambleja e Ortakëve do të konsiderohet e mbledhur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, të ngarkuar me detyrën e mbarëvajtjes së mbledhjes dhe mbajtjes së procesverbalit përkatës dhe që kanë të drejtën për të vendosur nënshkrimin në të.
- 15.3 Çdo Ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, qoftë ky ortak ose jo, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e të cilit mund të japë votën e tij. Në çdo rast prokura mund të lëshohet vetëm për pjesëmarrjen në një Asamble Ortakësh dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të saj.

Neni 16

Drejtimi i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve

- 16.1 Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve do të drejtohen nga Kryesuesi i mbledhjes që do të shtë Administratori, ose nga një person tjetër i pranishëm në mbledhje, nëse kjo vendoset me shumicën e të pranishmëve. Mbledhja e Ortakëve do të zgjedhë një sekretar për mbajtjen e shënimeve gjatë saj, i/e cili/a mund të mos jetë Ortak në Shoqëri.
- 16.2 Mbledhja do të shqyrtojë dhe vendosë vetëm mbi ato çështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës së njoftimit të dërguar për atë mbledhje të Asamblesë së Ortakëve. Diskutimet mbi çështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse japin pëlqimin dhe janë të pranishëm të gjithë Ortakët e Shoqërisë.
- 16.3 Do të konsiderohet si rezultat i votimit të kryer në një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve rezultati i njoftuar me zë nga ana e Kryesuesit të mbledhjes, pas kryerjes së votimit nga Ortakët. Në rast kundërshtimi të rezultatit të referuar me zë nga Kryesuesi i mbledhjes, qoftë dhe nga një prej Ortakëve, atëherë Asambleja e Ortakëve do të rihvillojë votimin për të njëjtën çështje duke votuar individualisht secili nga Ortakët.

Neni 17

Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve

- 17.1 Për çdo mbledhje dhe për çdo vendim që do të merret në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve do të mbahet një procesverbal. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregtar dhe një për secilin Ortak. Kopjet e procesverbaleve të vendimeve përkatëse të Asamblesë së Ortakëve do t'u dërgohen me letër rekomande të gjithë Ortakëve që nuk ishin të pranishëm në mbledhje, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas mbajtjes së Asamblesë së Ortakëve.
- 17.2 Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, në të cilën janë marrë vendime me shumicë të zakonshme firmoset nga Kryesuesi i mbledhjes dhe kundër firmoset nga Sekretari. Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve në të cilën janë marrë vendime me shumicë të jashtëzakonshme do të hartohet në prani të një noteri publik në Republikën e Shqipërisë dhe do të firmoset nga kryesuesi i mbledhjes dhe kundër firmoset nga sekretari.
- 17.3 Kryesuesi i mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve është përgjegjës për mbajtjen dhe shpërndarjen e procesverbalit.

Neni 18

Paditë kundër vendimeve të Asamblesë së Ortakëve

- 18.1 Administratori (ët) dhe çdo ortak që nuk ishte i pranishëm kur u mor vendimi ose që votoi kundër vendimit, ka të drejtë të kërkojë në gjykatën me juridiksionin përkatës anulimin e këtij vendimi në rast se ky vendim është marrë në kundërshtim me parashikimet e Aktit të Themelimit, të Statutit dhe/ose të ligjit në fuqi.

- 18.2 Nëse Administratori padit Shoqërinë, Asambleja e Ortakëve do të zgjedhë një përfaqësues të përkohshëm për përfaqësimin e Shoqërisë përpara Gjykatës.

PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 19

Administratori

- 19.1 Administratori drejton veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë sipas udhëzimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe përfaqëson Shoqërinë pranë çdo organi juridik, ose administrativ si dhe pranë palëve të treta, duke nënshkruar akte në emër e për llogari të saj.
- 19.2 Administratori mund të emërojë agjentë përfaqësues për veprime dhe/ose transaksione të ndryshme, duke përcaktuar kompetencat e tyre, si dhe kompensimin përkatës.
- 19.3 Administratori kryen funksionet e mëposhtme:
1. I propozon Asamblesë së Përgjithshme ndryshimin e Statutit të Shoqërisë, përfshirë ndryshimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, objektin e aktivitetit, dhe afatën e saj ligjor;
 2. propozon politikat e veprimtarisë së Shoqërisë dhe zbaton politikat e miratuara nga Asambleja e Ortakëve;
 3. miraton planet e prodhimit dhe aktivitetin e shitjeve të Shoqërisë, të nevojshme për plotësimin e qëllimeve të Shoqërisë dhe objektivave të saj, si dhe raportet për realizimin e këtyre planeve;
 4. propozon planin financiar dhe raportin për realizimin e tij;
 5. përcakton qëllimin, burimet e formimit dhe procedurat për përdorimin e fondeve të Shoqërisë;
 6. për qëllime të aktivitetit të Shoqërisë, merr vendime për kredi afatgjata për Shoqërinë dhe/ose detyrime dhe/ose miraton blerjen e asetëve të tjera vlera e të cilave nuk kalojnë vlerën kontabël të parashikuar në Nenin 13 të këtij Statuti. Në raste kur e vlerëson të arsyeshme, mund t'i kërkojë Asamblesë së Ortakëve miratimin paraprak të këtyre veprimeve;
 7. siguron që bilanci vjetor si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit, ose Statutit realizohen në mënyrën e duhur. Në këtë kuadër, Administratori bën çdo ndryshim në të dhënat e referencës së llogarive, ose në politikat e mbajtjes së llogarive;
 8. Miraton raportet tre mujore dhe përgatit pasqyrat financiare të Shoqërisë;
 9. Siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspert i kontabël i autorizuar dhe që raporti i këtij të fundit vihet në dispozicion të ortakëve;
 10. Propozon shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë dhe procedurat përkatëse;

11. Përcakton procedurat për mbulimin e humbjeve të Shoqërisë;
12. Shqyrton dhe mban librat e Shoqërisë, dokumentet dhe asetet;
13. Përcakton numrin e punonjësve, strukturën, kontratat tip, procedurat e brendshme të punës dhe shpërblimet e personelit të Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
14. kryen të gjitha veprimet për administrimin e Shoqërisë, të cilat vlerësohen si të duhura e në përputhje me qëllimin e Shoqërisë dhe që nuk i janë deleguar nga Akti i Themelimit, Statuti dhe/ose ligji Asamblesë së Përgjithshme;
15. drejton veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë duke vepruar në emër e për llogari të saj;
16. zbaton planet dhe politikat e Shoqërisë dhe raporton për përmbushjen e tyre pranë Asamblesë së Përgjithshme;
17. kryen administrimin e zakonshëm të pasurive të Shoqërisë, përfshirë dhe mjeteve financiare;
18. përfaqëson Shoqërinë përpara palëve të treta, Gjykatave, Arbitrazhit, nënshkruan kontrata dhe akte të tjera në emër dhe për llogari të Shoqërisë;
19. raporton dhe përgjigjet përpara Asamblesë së Përgjithshme mbi drejtimin dhe rezultatet e veprimtarisë së Shoqërisë;
20. thërret Asamblenë e Përgjithshme nëse kjo është e nevojshme për interesat e Shoqërisë; dhe
21. kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm dhe të lejueshëm, për arritjen e qëllimit të Shoqërisë.

19.4 Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë më tepër se një Administrator për Shoqërinë dhe në këtë rast do të përcaktojë dhe përgjegjësitë e tyre, në rast se Administratorët nuk do të ushtrojnë të gjithë kompetencat që u jep ky Statut.

19.5 Administratori do të jetë shtetas shqiptar, ndërsa Zëvendës Administratori (nëse ka) do të jetë shtetas i huaj. Në pamundësi zbatimi të rregullit të parashikuar në fjalinë e parë të këtij paragrafi, Këshilli i Administratorëve do të emërojë persona që nuk e përmbushin kushtin e shtetësisë, sikurse do të gjykojë të arsyeshme.

19.6 Shpërblimi i Administratorit do të caktohet nga Asambleja e Ortakëve. Në çdo rast, Administratorit do t'i kompensohen shpenzimet dhe kostot e ndryshme që kanë pësuar si rrjedhojë e ushtrimit të funksionit të tyre në Shoqëri.

PJESA VI

VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 20

Kontabiliteti, Viti Financiar dhe Dokumentet financiare

20.1 Shoqëria do të mbajë në mënyrë të saktë dhe të rregullt kontabilitetin dhe shënimet financiare të saj do të pasqyrojnë situatën e vërtetë ekonomike dhe financiare.

- 20.2 Kontabiliteti do të mbahet në valutën shqiptare (Lek). Çdo këmbim i valutës së huaj në lek dhe anasjellas do të realizohet sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së veprimit. Lëvizja e burimeve në valutë të huaj do të reflektohet në regjistrat përkatës të operacioneve.
- 20.3 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e krijimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit të të njëjtit vit.
- 20.4 Në fund të vitit financiar, Administratori përgatit pasqyrat vjetore, si dhe dokumentet e tjera kontabël të nevojshme, të cilat i paraqiten për miratim Asamblesë së Ortakëve brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.
- 20.5 Çdo tre muaj, Administratori përgatit raportet financiare tre mujore të të ardhurave dhe shpenzimeve të Shoqërisë dhe informon rregullisht ortakët në lidhje me to brenda 30 ditëve nga data e mbylljes së tre mujorit përkatës.
- 20.6 Dokumentet financiare të përgatitura për Shoqërinë, përfshirë pasqyrat financiare, bilancet, raportet e komisionit publik të revizionimit, do të mbahen në selinë e Shoqërisë për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) ditore duke filluar nga data e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë e deri në datën e mbajtjes së mbledhjes së saj, për t'u konsultuar nga ortakët e Shoqërisë në çdo moment.
- 20.7 Të gjitha dokumentet zyrtare financiare të Shoqërisë do të mbahen në selinë e saj për një periudhë të paktën 5 (pesë) vjeçare nga momenti i krijimit, ndërsa kopje të tyre mund të mbahen dhe në ambiente të tjera, qoftë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, qoftë jashtë tij.

Neni 21

Fitimi i Shoqërisë dhe fondet rezervë

- 21.1 I gjithë, ose një pjesë e fitimit neto të Shoqërisë mund t'i shpërndahet ortakëve në përputhje me pjesën e zotëruar prej tyre, sikurse mund të vendoset nga Asambleja e Ortakëve. Do të konsiderohet si fitimi neto i Shoqërisë, fitimi në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe detyrimeve të kërkueshme dhe alokimit të rezervave sipas Statutit, ose ligjit.
- 21.2 Shoqëria do të caktojë nga fitimet e saj një fond rezervë të barabartë me 10% (dhjetë për qind) të Kapitalit të Regjistruar të saj, duke alokuar për qëllim të këtij fondi rezervë 5 % (pesë për qind) të fitimeve vjetore.
- 21.3 Përveç fondit rezervë të parashikuar më lart, Shoqëria mund të krijojë fonde të tjerë për të cilat do të vendosë Asambleja e Ortakëve, duke përcaktuar shumën, qëllimin, procedurën

dhe tarifat e zbatueshme. Asambleja e Ortakëve gjithashtu mund të vendosë të shpërndajë shumat e fondeve rezervë që ajo ka në dispozicion, duke referuar llojet e rezervës nga të cilat janë marrë këto shuma, përmes një vendimmarrje me shumicë të zakonshme të saj.

- 21.4 Asnjë shpërndarje nuk mund t'u bëhet ortakëve, nëse pas kësaj shpërndarjeje kapitalet e Shoqërisë do të bëheshin më të ulëta se shumat e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe shumat e fondit rezervë dhe fondeve të tjera të detyrueshme, të krijuara nga Shoqëria në përputhje me këtë Statut dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe të cilat nuk mund të shpërndahen.

Neni 22

Kontrolli financiar

- 22.1 Për kontrollin e aktivitetit financiar të Shoqërisë dhe të degëve, a filialeve të saj mund të krijohet një Komision i Ekspertëve Financiar sipas legjislacionit në fuqi, i përbërë nga tre anëtarë të cilët ushtrojnë funksionin e tyre për një periudhë gjashtë vjeçare. Anëtarët dhe kryetari i këtij Komisionit do të emërohen nga Asambleja e Ortakëve, e cila përcakton dhe shpërblimin e tyre.
- 22.2 Komision Financiar do të mbledhet të paktën një herë në tre muaj për të inspektuar dhe asistuar Administratorin dhe Asamblesë të Ortakëve, pa pasur të drejtën e votës. Përpara mbledhjes së Asamblesë të Ortakëve, Komisioni Financiar do të inspektojë dhe auditojë aktivitetin kontabël të Shoqërisë dhe do të përgatisë Pasqyrat Financiare tre mujore dhe vjetore.

Neni 23

Punësimi

- 23.1 Problemet e punës, pagave, parimeve lidhur me shfrytëzimin e orëve të punës dhe pushimit, stimujt materialë dhe sigurimin e punës dhe të shëndetit rregullohen me kontrata pune. Për probleme që nuk janë parashikuar në kontratat e punës, do të zbatohen rregulloret e miratuara nga organet kompetente të Shoqërisë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi, veçanërisht Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 24

Prishja dhe likuidimi

- 24.1 Veprimtaria e Shoqërisë do të pushojë pas propozimeve të bërë nga një prej ortakëve, kur për një periudhë prej 2 vitesh të njëpasnjëshme Shoqëria është jo fitimprurëse, ose në raste të

tjera të vendosura nga të gjithë ortakët, ose nga autoritetet shtetërore shqiptare kur aktiviteti i Shoqërisë nuk përputhet me qëllimin dhe objektivat që rrjedhin nga Akti i Themelimit i lidhur ndërmjet palëve themeluese dhe nga Statuti.

24.2 Shoqëria do të priset dhe përmes:

- (a) vendimit të mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve;
- (b) bashkimit dhe përthithjes me një shoqëri tjetër;
- (c) vendimit të gjykatës me juridiksion përkatës, në rastet e parashikuara me ligj;
- (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.

24.3 Në rast prishje, Shoqëria do të likuidohet. Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore dhe këtij Statuti.

Neni 25

Likuidimi

25.1 Administratori propozon anëtarët e Komisionit të Likuidimit, i cili do t'i dorëzojë për miratim Asamblesë së Ortakëve raportin përfundimtar kontabël të likuidimit dhe dokumentet e tjera përkatës të nevojshëm në këtë rast. Në momentin e pushimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria do të publikojë likuidimin në Regjistrin Tregtar, sipas legjislacionit në fuqi.

25.2 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë me unanimitet të votave që mjetet e sjella nga njëri prej ortakëve në Shoqëri t'i kthehen atij ortaku duke e kredituar për koston e kthimit në vendin e ortakut.

25.3 Toka do t'i kthehet Shtetit Shqiptar në kushte të njëjta, ose të përmirësuar sikurse është marrë nga Shoqëria, përfshirë çdo përmirësim, ose pasuri të paluajtshme që është ndërtuar mbi tokën nga Shoqëria.

25.4 Fitimi që rezulton nga veprimtaria e filialeve, degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë si dhe pasuritë, pronat dhe fondet e krijuara nga Shoqëria, do të ndahen ndërmjet ortakëve në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, pasi të shlyhen borxhet dhe detyrimet e Shoqërisë dhe shpenzimet për likuidatorët.

PJESA VIII TË PËRGJITHSHME

Neni 26

Të ndryshme

- 26.1 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çështjet të cilat nuk përfshihen në këtë Statut, do të bëhet referim në legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe në atë tregtar në veçanti.
- 26.2 Në rast mosmarrëveshjesh të cilat mund të lindin si pasojë e zbatimit dhe interpretimit të këtij Statuti dhe/ose të Aktit të Themelimit të lidhur ndërmjet ortakëve themelues të Shoqërisë, palët do të mundohen t'i zgjidhin mosmarrëveshje të tilla me mirëkuptim ndërmjet tyre, në të kundërt ato do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 26.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe një pale të tretë do të zgjidhet miqësisht, në rast të kundërt çështja do t'i referohet për zgjidhje gjykatës e cila ka kompetencën dhe juridiksionin për zgjidhjen e saj, sipas legjislacionit të zbatueshëm në atë rast.

Neni 27


Ekzemplare

- 27.1 Ky statut është hartuar dhe nënshkruar në 5 (pesë) ekzemplarë në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secili dhe me të njëjtën përmbajtje dhe formë, sot me datë **15 Qershor 2017**.

ORTAKËT:

Z. Thoma JANI

Z. Vasilios IATROU



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Z. 